

Në bazë të nenit 25 paragrafit 1 të Vendimit mbi themelimin e trupave punuese të Kuvendit të Komunës së Tuzit („Fleta Zyrtare e Malit të Zi –dispozitat komunale“, nr.15.19) i dorëzoj Kuvendit të Komunës së Tuzit, këtë

R A P O R T

Nga seanca e III e Këshillit për planifikim dhe rregullim hapësinor, veprimtari komunale banimore, komunikacion dhe mbrojtje të mjedisit

Në Seancën e mbajtur më 31.01.2020, të pranishëm ishin: Fadil Kajoshaj,- kryetar i Kuvendit, Besa Nikaj, Mark Lucgjonaj, Sulejman Beqaj, Fatmir Beqiraj, Štjefan Camaj, Smail Çunmulla, përfaqësues të propozesit të aktit Leka Ivezaj dhe Nikollë Camaj. Nuk ishin të pranishëm kryetari Halil Dukoviq dhe anëtari Mirza Pepiq.

Kostatohet kuorumi për punë dhe vendimmarrje të seancës. Pas kësaj, kalohet në përcaktim të rendit të ditës.

Nga ana e kryesuesit propozohet ky rend dite:

1. *Propozim i Programit të rregullimit hapësinor i Komuns së Tuzit për vitin 2020.*
2. *Programi i punës së SH.P.K ” Komunalno/Komunale” për vitin 2020. Me Propozim Vendimin mbi dhënien e pëlqimit.*

Pas miratimit të rëndit të ditës, u kalua në shqyrtim dhe votim të pikave. Të dy pikat e rëndit të ditës janë miratuar me 6 (gjashtë) vota „PËR“.

Anëtarët e pranishëm të Këshillit për planifikim dhe rregullim hapësinor, veprimtari komunale banimore, komunikacion dhe mbrojtje të mjedisit janë të mendimit që propozimet e paraqiturave të akteve janë në pajtim me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe me dispozitat e tjera të vlefshme, me ç'rast i propozohen Kuvendit për miratim në senacë.

Për përfaqësues të Këshillit në seancën e Kuvendit të Komunës së Tuzit e cila është e caktuar me datë 31. 01.2020 në orën 14 është vendosur të jetë Fadil Kajoshaj, kryetar i Kuvendit.


KRYETAR I KUVENDIT
Fadil Kajoshaj